



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.16.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË
MEDIAVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Emine Fazliu, e mbështetur nga, Faruk Rrahmani - Udhëheqës Ekipi, dhe Mazlumsha Sejfadini - Anëtar Ekipi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	20
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	21
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	24


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2015 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë, Kryetarin e Komisionit, Kryeshafen Ekzekutive si dhe stafin për ndihmën e dhënë gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarr e reflekton qasjen e paraqitur në Memorandumin e Planifikimit të datës 2 tetor 2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I): :



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat vjetore financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në pjesën 1.2 të këtij raporti.

Menxhimi i rrezikut dhe implementimi i rekomandimeve të vitit paraprak nuk janë adresuar siç duhet për të siguruar arritjen e objektivave dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të organizatës.



Kryetari i komisionit duhet të zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku progresi i raportohet menaxhmentit në baza mujore. (shih çështjet 1,2 dhe 3)

Vetëm 46% e të hyrave të vitit 2015 ishin inkasuar në afatin e paraparë me rregulloren përkatëse. Të arkëtueshmet kishin arritur vlerën prej 174,002€ me një trend të rritjes nëpër vite. Derisa pasuritë kontigjente ishin në vlerë prej 222,753€.



Kryetari i Komisionit duhet të gjejë mekanizma tjerë për arkëtimin e të hyrave siç janë revokimi i licencës për operatorët që nuk paguajnë me kohë, për të siguruar respektimin e afatit, më 31 mars, për inkasimin e të hyrave. (shih çështjet 6 dhe 7)

Përgjigja e Menaxhmentit të KPM-së - auditimi 2015

Menaxhmenti i KPM-së ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyra financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të KPM-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga KPM, dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i KPM-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e parasë së gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshëm të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryeshefi Ekzekutiv dhe Komisioni i KPM-së janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KPM-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për PVF në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PVF-të në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

PVF-të e KPM-së duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Kërkesat që PVF-të të jenë përgatitur në gjuhën Shqipe dhe Serbe, të jenë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF dhe të jenë dorëzuar në MF; dhe
- Kërkesat e Rregullores 01/2013 - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Në Pasqyrat Vjetore Financiare ishin të nevojshme disa korrigjime në pjesën e shënimeve shpjeguese. Për të siguruar raportimin e duhur të shënimeve shpjeguese ne sugjeruam korrigjimet si në vijim:

- *Te shënimi 30 Pasuritë kontingjente* - vërejtëm se llogaritë e arkëtueshme të vitit 2014 në vlerë prej 79,166€ ishin prezantuar si pasuri kontingjente ende pa u bërë përpjekje për arkëtimin e tyre përmes Gjykatës ose shërbimeve të Përmbarimit. Me qenëse kjo përpjekje nuk ishte bërë atëher këto llogari nuk mund ta marrin statusin e Pasurive kontingjente por duhet të mbeten si të arkëtueshme; dhe
- *Te shënimi 35 Të arkëtueshmet* - 20,000€ të hyrat nga kamata ishin regjistruar gabimisht si të hyra nga gjrobat e inspektoratit.

Pas sugjerimeve tona KPM ka korrigjuar PVF-të dhe versionin final nuk përmban gabime tjera.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm nga KPM kërkohet të adresoj raportimet si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Dorëzimi i raporteve të rregullta tremujore në Kuvend;
- Draft plani dhe plani final i prokurimit;
- Raportet mbi obligimet e dorëzuara në MF;
- Raporti i vetvlerësimit sipas rregullave të MFK-së; dhe
- Raporti vjetor i performancës.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PVF-ve dhe raportimit të jashtëm ishin përmbushur dhe kishin një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KPM-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin tre të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda KPM-së, veçanërisht në lidhje me implementimin e rekomandimeve nga viti paraprak dhe menaxhimin e rrezikut. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh nëpër sistemet kyçe financiare. Ne kemi konstatuar se kontrollet në disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që KPM të ketë vlerë të dobët për parandë dhe menaxhim jo efektiv. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë implementimi i rekomandimeve, eliminimi i mangësive të konstatuara nga vetvlerësimi si dhe identifikimi dhe menaxhimi i rrezikut si një komponentë shumë e rëndësishme.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 ka rezultuar me pesë rekomandime. KPM ka përgatitur një plan veprimi për të siguruar se rekomandimet do të adresohen brenda periudhës së specifikuar. Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike ka mbajtur seancë për diskutimin e raportit të auditimit për KPM. Nga ky takim Komisioni ka kërkuar që KPM të implementoj rekomandimet e dhëna në raport. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, KPM kishte arritur të impementojë tre rekomandime ndërsa dy rekomandime nuk ishin adresuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 1 - Implementimi i rekomandimeve të vitit paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Dy rekomandimet e vitit të kaluar që kanë të bëjnë me arkëtimin e të hyrave dhe të arketueshmeve nuk ishin adresuar. Përkundër ndryshimit të rregullores për licencim dhe përpjekjeve përmes shkresave dhe konferencave mediale për të bërë presion dhe të bind operatorët e mediave audio-vizuele që të paguajnë obligimet, kjo nuk ka dhënë rezultate. Sanksionet për ndërprerjen e licencës siç parashihen me rregulloren KPM-2014/03 nuk ishin aplikuar.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme në arkëtimin e të hyrave ndikojnë në:

- Rritjen e të arketueshmeve nga viti në vit, dhe në zvoglimin e mundësisë për mbledhjen e tyre si rezultat i joefikasitetit në aplikimin e sanksioneve; dhe
- Të hyrat e mbledhura për buxhetin ishin më të vogla se ato të planifikuara.

Rekomandimi 1 Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet duke përcaktuar afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, duke u fokusuar në gjetjen e zgjidhjeve për mbledhjen e të hyrave në mënyrë të plotë dhe me kohë. Vendimi për revokim të licencave për operatorët që nuk kryejnë obligimet mund të jetë një formë që komisioni duhet ta vlerësojë seriozisht.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për KPM më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP. Kjo nuk ka për qëllim të japë komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetvlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi konstatuar se:

- Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur, nuk ishte hartuar ndonjë liste e rreziqeve dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
- Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia e digitalizimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto) konsiderohen si të vendosura nga ana e KPM-së. Strategjia për kalim në sistemin digjital duhet të aprovohet nga Qeveria. KPM e ka finalizuar strategjinë dhe e ka dorëzuar në Qeveri më 31 mars 2015, mirëpo ende nuk është aprovuar; dhe
- Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga KPM.

Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda KPM-së që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këta mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes dobësojnë proceset strategjike dhe operacionale dhe zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
- Rekomandimi 2** Kryetari i komisionit duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KPM operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara me procedurat e MFK dhe rregullës 01/2010 kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv, operacional dhe strategjik.

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut - Prioritet i lartë

- E gjetura** KPM nuk kishte identifikuar dhe as hartuar ndonjë listë të rreziqeve përfshirë planin e veprimit për menaxhimin e tyre. Kjo gjendje është konfirmuar edhe nga vet KPM përmes pyetësorit të plotësuar të vetvlerësimit ku ishte theksuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale.
- Rreziku** Mos menaxhimi i rreziqeve të mundshme ndaj objektivave organizative ndikon në cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 3** Kryetari i komisionit duhet të sigurojë se kryeshefi ekzekutiv ka menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive përmes delegimit të përgjegjësive tek nivelet tjera përkatëse dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë duke monitoruar se si rreziqet janë duke u menaxhuar.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) gjatë vitit 2015 ka funksionuar vetëm me një staf – që ishte edhe Drejtor i NJAB.

NJAB ka hartuar planin strategjik të auditimit të brendshëm që përfshinë periudhën 2015-2017, ku ishin parapare objektivat strategjike. Plani vjetor ishte mbështetur në planin strategjik dhe ishte hartuar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve të tyre. Në planin vjetor NJAB kishte planifikuar auditime në: menaxhim të frekuencave, departamentin e monitorimit, departamentin e prokurimit, dhe departamentin e financave.

Auditori i brendshëm ka mbuluar fusha të rëndësishme të aktiviteteve të KPM-së dhe ka hartuar raporte cilësore dhe përmbajtësore duke dhënë rekomandime të qarta dhe konkrete. Në tri raportet e finalizuara, NJAB kishte dhënë tetë rekomandime se si menaxhmenti të përmirësojë funksionimin e kontrollit të brendshëm. Të gjitha rekomandimet ishin në proces të adresimit.

Në dhjetor të vitit 2015, auditori i brendshëm kishte dhënë dorëheqje. Sipas UA 23/2009, KPM për vitin 2016 nuk i plotëson kriteret¹ për themelimin e NJAB-it. KPM duhet të shqyrtojë mundësinë që shërbimet e auditimit të brendshëm t'i siguroj përmes themelimit të njësisë së përbashkët me institucionet tjera të pavarura.

¹ Të ketë mbi 50 të punësuar ose mbi 1 milë buxhet

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket KPM-së, mbledhja e të hyrave të vitit aktual dhe mbledhja e të arkëtueshmeve të viteve paraprake mbetet shqetësim. Nuk janë duke u zbatuar rregulloret përkatëse dhe kjo ka rezultuar me vonesa të mëdha në mbledhjen e të hyrave. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

Një kujdes i shtuar duhet vendosur te blerja dhe procesimi i pagesave nga kategoria adekuate duke eliminuar gabimet e ndodhura.

3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	794,342	1,254,162	1,252,431	1,370,440	752,987
Të hyrat vetjake të bartura					45,323
Granti i Qeverisë -Buxheti	794,342	1,254,162	1,252,431	1,370,440	707,664

Buxheti final, është më i lartë për 459,820€ se ai fillestar. Kjo rritje reflekton aprovimin e vazhdimet të dy projekteve kapitale me rishikim të buxhetit në vlerë prej 577,112€. Zvoglim të buxhetit me rishikim kishte te kategoritë pagat & medijtjet dhe mallra & shërbime.

Në vitin 2015, KPM ka përdorur 99.86% të buxhet final ose 1,252,431€, me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2014.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike-shpenzimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	794,342	1,254,162	1,252,431	1,370,440	752,987
Pagat dhe Mëditjet	440,937	362,239	362,239	331,777	296,475
Mallrat dhe Shërbimet	336,405	287,812	286,879	335,977	430,097
Shërbimet komunale	17,000	26,999	26,999	17,000	17,086
Investimet Kapitale	0	577,112	576,313	685,686	9,329

Shpenzimet nëpër kategori në raport me buxhetin në përgjithësi ishin të kontrolluara mirë. Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Me rishikim të buxhetit kategoria e pagave dhe mëditjeve ishte zvogëluar për 78,698€. Ndërsa në fund të vitit bazuar në vendimin e Qeverisë nr. 12/64 MF ka marrë 7,905€ si kursime buxhetore;
- Me rishikim të buxhetit zvoglim kishte edhe në kategorin e mallrave dhe shërbimeve për 38,421€, ndërsa 10,000€ tjera janë në kategorin e shërbimeve komunale; dhe
- Me rishikim të buxhetit ishte aprovuar buxheti për vazhdimin e projekteve kapitale të vitit 2014 në vlerë prej 580,265€. Me vendim të Qeverisë nr. 05/67 shuma prej 3,153€ i është marrë KPM-së nga MF si kursime buxhetore.

Tabela 3. Të hyrat për buxhetin e Kosovës - në tri vite (në €)

Përshkrimi	Të hyrat e planifikuara	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat	343,605	309,326	325,162	401,972

Në vitin 2015, KPM ka planifikuar të realizoj të hyra nga licencat e operatorëve në vlerë prej 343,605€. Inkasimi i të hyrave në vitin 2015 ishte 309,326€ përfshirë edhe pagesat e viteve paraprake, gjobat dhe kamatat.

Nga tabela shihet një rënie e inkasimit të të hyrave nga viti paraprak në vlerë prej 15,836€ e cila rrjedhë kryesisht nga mos efikasiteti i mbledhjes së të hyrave që ka rezultuar me rritje të të arkëtueshmeve. Kjo është shtjelluar më detajisht në pjesën 3.6.

Çështja 4 - Blerja dhe procesimi i pagesës nga kategoria jo adekuate - Prioritet i mesëm

- E gjetura** KPM ka blerë një pajisje (stabilizator) e cila nuk ishte paraparë në planin e prokurimit. Sipas zyrtarëve të KPM-së blerja ka qenë emergjente sepse mos forcimi i energjisë elektrike me stabilizator ka rrezikuar prishjen e të gjitha pajisjeve në sistemin e monitorimit. Në munges të buxhetit në kategorinë e kapitaleve janë detyruar që blerjen ta kryejnë nga kategoria mallra dhe shërbime. Kjo blerje i takon kategorisë së investimeve kapitale për nga vlera dhe jetëgjatësia e pajisjes.
- Rreziku** Blerjet nga kategoria jo përkatëse mund të rezultojë në keqkuptimin e pozitës financiare të organizatës dhe gabimet domethënëse mund të rezultojnë me modifikim të opinionit.
- Rekomandimi 4** Në raste të blerjes nga mjetet e buxhetuara për kategorit tjera, KPM duhet së pari të bëjë transferin e buxhetit nga një kategori në kategorin tjetër buxhetore në përputhje me rregullat financiare të cilat lejojnë që deri në shumën prej 5% mund të bëhet nga ZKA pa aprovim paraprak nga Ministri i Financave.

3.4 Prokurimi

Në vitin 2015, KPM kishte përfunduar 16 procese të prokurimit, 15 ishin për kategorin mallra dhe shërbime ndërsa një procedur për investime kapitale. Vlera e këtyre kontratave të nënshkuara ishte 357,311€³. Për të vlerësuar rregullsinë e pagesave, testuam shtatë procedura të prokurimit të cilat kishin rezultuar me kontrata në vlerë prej 337,161€. Nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi që do të mund të raportohet.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet jo përmes prokurimit nënkuptojnë të gjitha ato blerje të cilat nuk kërkojnë aplikimin e procedurave të prokurimit publik. Gjatë testimeve ne nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

³ Në vlerën e kontratave bëjnë pjesë edhe kontratat kornizë dy ose tri vjeçare

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel qendror nga KPM kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke nënshkruar listën e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve dhe rishikimin e buxhetit për këtë kategori si dhe barazimet me thesarin.

Ne rishikuam listat e pagave si dhe krahasuam të dhënat e prezantuara nga Thesari - SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar mostra, duke përfshirë dosjet e personelit. Bazuar në këtë kemi konstatuar se KPM, ka vendosur sisteme të mira të kontrollit mbi fushën e kompensimeve (pagave dhe mëditjeve).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Të Hyrat

Gjatë vitit 2015, KPM ka realizuar të hyra në vlerë 309,326€. Të hyrat nga aplikimi për licencë si dhe nga licencat që i takojnë vitit 2015 janë 285,825€. Ndërsa të hyrat që i takojnë viteve paraprake përfshirë licencën, kamatën dhe gjobat janë 23,501€.

Në qoftë se e shohim si inkasim nëpër vite, vërejmë një trend të rënies së inkasimit të të hyrave.

Çështja 5 - Mekanizma jo efikas për mbledhjen e të hyrave - Prioritet i lartë

E gjetura Rregullorja në fuqi ka paraparë që pagesa duhet të kryhet nga operatorët deri më 31 mars të vitit vijues. Kjo rregullore si dhe mekanizmat që ka vendosur KPM për inkasimin e të hyrave nuk janë treguar efikas.

Nga raporti i pagesave shihet se ka vonesa, deri në mars janë inkasur 158,492€ apo 46% e shumës së planifikuar. Nese e krahasojmë inkasimin e periudhës janar-mars të vitit 2015 me periudhën e njëjtë të vitit 2014 vërejmë se kishte rënie në inkasimin e të hyrave për 55,374€. KPM ka bërë përpjekje përmes komunikimeve me Operatorët Ekonomik dhe shpalljes publike të borxhlinjëve që janë ndaj saj, por deri më tani kjo nuk ka dhënë ndonjë rezultat.

- Rreziku** Shtyrja e afatit të pagesës nga janari në mars dhe lirimi nga kamata me rregulloren e re nuk kishte dhënë efekte në rritjen e shkallës së inkasimit. Vonesat në arkëtim tregojnë që të hyrat nuk janë në dispozicion në kohën e duhur dhe kjo ndikon që buxheti i Kosovës të mos ketë shumën e planifikuar të të hyrave në kohën e duhur.
- Rekomandimi 5** Efektet e ndryshimit të rregullores nuk janë materializuar dhe si pasojë Kryetari i Komisionit duhet të gjejë mekanizma tjerë më efektiv siç mund të jetë revokimi i licencës për operatorët që nuk paguajnë me kohë obligimet.

3.7 Pasuritë dhe obligimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Kemi rishikuar procesin e menaxhimit të pasurive dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së pasurisë nëse janë mbajtur në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Të dhënat e prezantuara në PVF janë në përputhje me evidencat e regjistrit kontabel, dhe regjistrin të e-pasurisë si për pasuritë me vlerë mbi 1,000€ ashtu edhe ato nën 1,000€.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

KPM, krijon të hyra nga licencimi i operatorëve që ofrojnë shërbime audio-vizuele. Mos pagesa me kohë nga operatorët krijon të arkëtueshme. Të arkëtueshmet e pambledhura pastaj procedohen në gjykatë dhe raportohen si pasuri kontingjente nga KPM.

Çështja 6 - Rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmeve -Prioritet i lartë

- E gjetura** Të arkëtueshmet/Pasuritë kontingjente të KPM-së, deri më 31 dhjetor 2015 kishin arritur vlerën prej 396,755€. Prej tyre si llogari të arkëtueshme janë 174,002€ dhe pasuri kontingjente 222,753€. Niveli i lartë i të arkëtueshmeve dhe jo efikasiteti në mbledhjen e tyre mund të shihen edhe nga trendi i rritjes nëpër vite. Këtë vit të arkëtueshmet janë rritur për 51,745€ krahasuar me vitin paraprak.
- Rreziku** Mos inkasimi i të arkëtueshmeve prej vitit në vit rezulton në një humbje të drejtpërdrejtë financiare për KPM-në dhe Buxhetin e Kosovës.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komisionit duhet të rishkojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës.

3.7.3 Trajtimi i obligimeve

Vlera e obligimeve të prezantuara në PVF-të e vitit 2015 ishte 29,266€. Përderisa obligimet në vitin 2014 ishin 46,798€. Obligimet e prezantuara i takojnë muajit dhjetor 2015 dhe vërehet se trendi i obligimeve krahasuar me vitin paraprak është në rënie.

Te gjitha këto obligime i takojnë kategorive mallra dhe shërbime si dhe komunal, kjo ishte rezultat i mungesës së buxhetit. Këto obligime mbeten për tu paguar me buxhetin e vitit 2016.

Raportimi i obligimeve në thesar ishte bërë në çdo muaj dhe në kohën e parapare me rregulloren për raportimin e obligimeve.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
4.2 Te hyrat	Kryetari i Komisionit duhet të monitoroj zbatimin e rregullores së re në praktikë për të siguruar respektimin e afatit të rishikuar, më 31 mars, për inkasimin e të hyrave. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime shtesë për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuar të viteve paraprake.			Ky rekomandim nuk është zbatuar deri në këtë fazë të auditimit.
4.3 Shpenzimet me prokurimit	Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se departamenti i prokurimit me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit, çdo kriter duhet ta precizojë qartë për të konfirmuar ofrimin e shërbimit të një standardi të duhur.	KPM e ka adresuar këtë rekomandim.		
4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari i Komisionit duhet të siguroj që në rastet kur ekziston rreziku që malli që ofrohet mund të mos jetë në sasinë dhe cilësinë e duhur të formojë komisione të pranimit për të shtuar masat e kontrollit.	KPM e ka adresuar këtë rekomandim.		

<p>4.4 Pasuritë dhe Obligimet</p>	<p>Kryetari i Komisionit duhet të ndërmerr veprime konkrete me qëllim që të siguroj fillimin e përdorimit të sistemit "e-pasuria", në mënyrë që të shfrytëzohen shërbimet e këtij sistemi. Fillimisht duhet kërkuar nga MAP-i si kontraktor i këtij sistemi të siguroj trajnime për stafin për aplikimin e këtij sistemi. Me funksionalizimin e këtij sistemi mundësohet edhe menaxhimi i depos dhe evitohen mangësitë aktuale.</p>	<p>KPM e ka adresuar këtë rekomandim.</p>		
<p>4.4.2 Llogarite e arketueshme</p>	<p>Kryetari i Komisionit duhet të rishkojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës dhe të konfiskimit të pajisjeve.</p>			<p>Ky rekomandim nuk është zbatuar deri në këtë fazë të auditimit.</p>